

Член 45

Во член 230-г зборовите: „од 2.000 до 3.000“ се заменуваат со зборовите: „од 200 до 400“.

Член 46

Во член 230-д зборовите: „од 10.000“ се заменуваат со зборовите: „од 800 до 1.000“.

Член 47

Во член 230-ѓ зборовите: „од 2.000 до 3.000“ се заменуваат со зборовите: „од 300 до 500“.

Член 48

Членот 230-е се брише.

Член 49

Во член 230-ж зборовите: „од 2.000 до 3.000“ се заменуваат со зборовите: „од 300 до 500“.

Член 50

Членот 231 се менува и гласи:

„(1) За прекршоците од членовите 226, 227, 228, 229, 229-а, 230, 230-а 230-б, 230-г, 230-д, 230-ѓ и 230 -ж од овој закон, надлежниот инспектор пред да поднесе барање за поведување на прекршочна постапка должен е на сторителот да му предложи постапка за порамнување со издавање на прекршочен платен налог согласно со Законот за прекршоците.

(2) Доколку сторителот не се согласи да му биде издаден прекршочен платен налог, истото ќе се забележи во записникот за констатиран прекршок, а овластеното службено лице ќе поднесе барање за поведување на прекршочна постапка пред надлежен суд.

(3) Кога сторителот на прекршокот е согласен со постапката за порамнување, инспекторот составува записник и му издава прекршочен платен налог на одговорното лице или од него овластено лице кај работодавач.

(4) Записникот и платниот налог ги потпишуваат инспекторот и сторителот на прекршокот. По приемот на прекршочен платен налог сторителот е должен да ја плати глобата изречена во прекршочниот налог во рок од осум дена од денот на приемот на прекршочен платен налог, на сметка на органот назначен во прекршочен платен. (налог)

(5) Кога како сторител на прекршок се јавува правно лице, записникот и прекршочниот платен налог го потпишува одговорното лице или од него овластено лице.

(6) Сторителот кој ќе ја плати глобата во рокот од ставот (4) на овој член, ќе плати само половина од изречената глоба за кое право се поучува во правната поука.

(7) Ако сторителот не ја плати глобата во рокот од ставот (4) на овој член, инспекторот ќе поднесе барање за поведување прекршочна постапка до надлежен орган.

(8) Во постапката за порамнување глобата во прекршочниот платен налог се изрекува во минималниот пропишан износ за прекршокот.

(9) Во постапката која ќе заврши со плаќање на прекршочен платен налог не се плаќаат трошоци на постапката.

(10) Формата и содржината на прекршочниот платен налог ги пропишува министерот.“

Член 51

Започнатите постапки по барањата за остварување на правата на детски додаток и додаток за образование до денот на влегувањето во сила на овој закон ќе завршат согласно со овој закон.

Корисниците на правото на детски додаток и на додаток за образование ќе продолжат да го користат правото согласно со овој закон.

Член 52

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од 90 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Актот за професионални компетенции на стручниот и раководниот кадар од членот 17 од овој закон ќе се донесе во рок од една година од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 53

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Северна Македонија да утврди пречистен текст на Законот за заштита на децата.

Член 54

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19 dhe 146/19) në nenin 27 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse fjalët: “6.000 denarë” zëvendësohen me fjalët: “6.800 denarë”.

Neni 2

Në nenin 39-b paragrafi (2) në fjalinë hyrëse fjalët: “6.000 denarë” zëvendësohen me fjalët: “6.800 denarë”.

Pas paragrafit (6) shtohet paragraf i ri (7), si vijon:

“(7) Shfrytëzuesi i së drejtës së shtesës për arsim duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 3

Në nenin 39-v në paragrafin (3) pas alinesë 3 shtohet aline e re 4, si vijon:

“-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, fëmija i është besuar babait për ta ruajtur, edukuar dhe mbajtur.”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

“(4) PAGESA E SHTESËS PËR ARSIM I BËHET EDHE KUJDESTARIT I CILI KUJDESET PËR MBAJTJEN E FËMIJËS, SI DHE PERSONIT I CILI ME VENDIM TË QENDRËS KOMPETENTE PËR PUNË SOCIALE I ËSHTË BESUAR FËMIJA DHE JETON NË FAMILJE ME TË.”

Neni 4

Në nenin 39-g fjalët: “prindër dhe” zëvendësohen me fjalët: “prindër dhe/ose”.

Neni 5

Pas nenit 41 shtohet nen i ri "41-a" si vijon:

"Neni 41-a

Pagesa e shtesës së fëmijës, shtesa e veçantë dhe/ose shtesa për arsimin për fëmijën që është pa kujdes prindëror, ndërsa është vendosur në familje përkujdesëse në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet qendrës për punë sociale dhe përkujdesësit, i bëhet përkujdesësit".

Neni 6

Në nenin 42 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Ankesa nga paragrafi (2) i këtij neni, parashtrohet përmes qendrës kompetente për punë sociale".

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 7

Në nenin 43 në paragrafin (1) fjalët: "pikat 1, 2, 3 dhe 4" zëvendësohen me fjalët: "pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5".

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Ministria mund të lëshojë vërtetim ose certifikatë nga paragrafi (1) i këtij neni si dokument elektronik nga sistemi për evidencën e të dhënave për mbrojtje sociale me të cilën menaxhon, i vërtetuar me vulë elektronike, në pajtim me Ligjin për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime të besueshme dhe Ligjin për menaxhim elektronik dhe shërbime elektronike.

(3) Vërtetimi ose certifikata e lëshuar në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni kanë fuqi juridike dhe dëshmuese si forma e tyre me shkrim".

Paragrafi (2) bëhet paragraf (4).

Neni 8

Në nenin 50 pas paragrafit (2) shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5), si vijojnë:

"(3) Nëse shfrytëzuesi nga paragrafi (2) i këtij neni vdes, qendra për punë sociale ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara në lartësi të pjesës së trashëguar të shfrytëzuesit të së drejtës.

(4) Qendra për punë sociale nuk do të kërkojë kthim të mjeteve të pranuar, nëse me pagesën e këtyre mjeteve trashëguesit e shfrytëzuesit dhe anëtarët e familjeve të tyre më të ngushtë mbeten pa minimum mjete për ekzistencë, më të ulëta se lartësia e ndihmës së garantuar minimale të përcaktuar në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale.

(5) Kërkesa për kthimin e shumës së mjeteve të paguara nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni kanë të bëjnë vetëm me kërkesa të paguara të maturuara në shumë të përgjithshme të përllogaritur nga dita e pagesës së mjeteve të realizuara në mënyrë kundërligjore në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, deri në ditën e maturimit të kërkesës, bashkë me kamatën e përllogaritur ligjore."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (6).

Paragrafi (4) i cili bëhet paragraf (7) ndryshohet si vijon:

"(7) Afatet e maturimit për kërkesën për kthimin e shumës së mjeteve të paguara dhe për kërkesën për kompensim të dëmit në pajtim me këtë ligj fillojnë të rrjedhin:

- në rastet nga paragrafi (2), alinetë 1 dhe 2 të këtij neni nga dita e cila është përcaktuar me aktvendimin final se shfrytëzuesi e ka fituar të drejtën e mbrojtjes së fëmijëve në mënyrë kundërligjore, dhe

- në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për shpallje të trashëgimtarëve të shfrytëzuesit të të drejtave të mbrojtjes së fëmijëve."

Në paragrafin (5), i cili bëhet paragraf (8), fjalët: "në këtë nen" zëvendësohen me fjalët: "në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni".

Paragrafi (6) bëhet paragraf (9).

Në paragrafin (7), i cili bëhet paragraf (10), fjalët: "nga paragrafi (2) i këtij neni" zëvendësohen me fjalët: "nga mbrojtja e fëmijëve".

Neni 9

Në nenin 60, pas paragrafit (7) shtohen dy paragrafë të rinj (8) dhe (9), si vijojnë:

"(8) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(9) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e të drejtës së nenit 6 paragrafi (1) pika 6) e këtij ligji i përcakton ministri".

Paragrafët (8), (9) dhe (10) bëhen paragrafë (10), (11) dhe (12).

Neni 10

Në nenin 92 pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri (8) si vijon:

"(8) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit".

Paragrafët (8) dhe (9) bëhen paragrafë (9) dhe (10).

Neni 11

Në nenin 102-a në paragrafin (4) pas fjalëve: "kushtet hapësinore" shtohen fjalët: "ndryshimi i kapacitetit".

Neni 12

Në nenin 109 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Ushtruesi i detyrës drejtor në paragrafin (2) alineja 9 i këtij neni është person i cili përveç kërkesave të përgjithshme të përcaktuara me ligj, është me arsim të lartë të përfunduar (me 240 kredi të fituara sipas SETK ose ka të mbaruar shkallën VII /1)".

Neni 13

Në nenin 145, në paragrafin (1), pas fjalëve: "institucioni për fëmijë" vihet presje dhe shtohen fjalët: "kopsht fëmijësh / qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucion i arsimit të lartë dhe shkollë private".

Neni 14

Në nenin 177-a në paragrafin (2) alineja 4 ndryshohet si vijon:

"- të mos i jetë hequr e drejta prindërore,".

Neni 15

Në nenin 177-e paragrafi (7) fjalët: "tre vjet" zëvendësohen me fjalët: "tre muaj".

Neni 16

Në nenin 180 alineja (4) ndryshohet si vijon:

"- me vendim të plotfuqishëm i shqiptohet ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës deri sa të zgjasin pasojat nga ndalimi."

Pas alinesë 4 shtohet aline e re 5 si vijon:
"- i është hequr e drejta prindërore,".

Neni 17

Pas nenit 182 shtohet nen i ri 182-a si në vijim:

"Neni 182-a

Kompetencat profesionale të kuadrit profesional dhe udhëheqës dhe organizimi i zhvillimit të tyre profesional në institucionet e fëmijëve i përcakton ministri".

Neni 18

Në nenin 204, në paragrafin (1), pas fjalëve "institucionet për fëmijë" vihet presje dhe shtohen fjalët: "kopsht fëmijësh / qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucion i arsimit të lartë dhe shkollë private".

Neni 19

Në nenin 205, në paragrafin 5 pas fjalëve: "institucionet për fëmijë" vihet presje dhe shtohen fjalët: "kopsht fëmijësh / qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucion i arsimit të lartë dhe shkollë private".

Në nenin 7, pas fjalës "institucionet" vihet presje dhe shtohen fjalët: "kopsht fëmijësh / qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucion i arsimit të lartë dhe shkollë private".

Neni 20

Në nenin 206 paragrafin (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikëqyrja inspektuese mund të kryejnë inspektorët nga shërbimi inspektues i Ministrisë me licencën e marrë për inspektor."

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2) si vijon:

"(2) Inspektori mund të jetë person i cili i plotëson kushtet e veçanta në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë dhe Ligjin për mbikëqyrje inspektuese".

Në paragrafin (2), që bëhet paragrafi (3), pas fjalës "përcakton" shtohen fjalët: "dhe autorizon", ndërsa pas fjalës "ligji", pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "dhe Ligji për mbikëqyrje inspektuese".

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Paragrafi (4) që bëhen paragraf (5) ndryshon si vijon:

"(5) Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi (4) të këtij neni, mënyrën e lëshimit, përdorimit, revokimit dhe regjistrimit të legjitimacioneve të lëshuara dhe të revokuara i përcakton Këshilli Inspektues".

Paragrafi (5) bëhet paragraf (6).

Neni 21

Në nenin 207 paragrafin (1) ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrje inspektuese mund të kryejnë edhe inspektorët e autorizuar nga kryetari i komunës, në komunën e qytetit të Shkupit, përkatësisht qyteti i Shkupit nga shërbimi inspektues komunal, që i plotësojnë kërkesat për inspektor dhe të cilët kanë marrë licencën për inspektor në fushën e shërbimit inspektues në Ministri".

Në paragrafin (2) në fjalinë hyrëse fjalët: "person i autorizuar" zëvendësohen me fjalët: "Inspektor i autorizuar".

Paragrafët (3),(4),(5) dhe (6) ndryshohen si vijojnë:

"(3) Nëse kryetari i komunës, në komunën e qytetit të Shkupit përkatësisht qytetit të Shkupit nga radhët e shërbimit inspektues komunal nuk është autorizuar inspektor përkatësisht nuk ka inspektor të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me këtë ligj, mbikëqyrjen do ta kryejë inspektori në Ministrinë në emër dhe për llogarinë e komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit.

(4) Nëse kryetari i komunës, në komunën e qytetit të Shkupit përkatësisht qytetit të Shkupit nga radhët e shërbimit inspektues komunal autorizon inspektor përkatësisht ka inspektor të autorizuar, ndërsa e mbikëqyrjen inspektuese të njëjtë nuk e kryen, në këtë rast mbikëqyrjen e kryen do ta kryejë inspektori në Ministrinë në emër dhe në llogarinë e komunës, komunës së qytetit të Shkupit, përkatësisht qytetit të Shkupit.

(5) Inspektori i autorizuar posedon legjitimacion zyrtarë.

(6) Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi (5) të këtij neni, mënyrën e lëshimit, përdorimit, revokimit dhe regjistrimit të legjitimacioneve të lëshuara dhe të revokuara i përcakton Këshilli Inspektues."

Neni 22

Në paragrafin 208 fjalët: "person i autorizuar" zëvendësohen me fjalët: "Inspektor i autorizuar".

Neni 23

Neni 208-a ndryshohet si vijon:

"(1) Udhëheqësi i shërbimit inspektues përpilon plan vjetor për punën e shërbimit inspektues më së voni deri në fund të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm, i cili publikohet në faqen e Ministrisë.

(2) Plani vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, më së voni deri më 15 nëntor dorëzohet në Këshillin Inspektues, në formë elektronike dhe në formë me letër.

(3) Udhëheqësi i shërbimit inspektues të komunës dhe të komunës në qytetin e Shkupit, përkatësisht në qytetin e Shkupit, përgatit plan vjetor për punën e shërbimit inspektues më së voni deri në fund të vitit rrjedhës, për vitin e ardhshëm, që publikohet në ueb faqen e komunës, dhe në komunën në qytetin e Shkupit, përkatësisht në qytetin e Shkupit.

Neni 24

Në nenin 209 në paragrafin (1) fjala: "kryhet" zëvendësohet me fjalët: "inspektori e kryen".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrja e rregullt paralajmërohet dhe realizohet në bazë të planit vjetor të shërbimit inspektues."

Në paragrafin (3) fjalët: "është mbikëqyrje e paparlajmëruar" zëvendësohen me fjalët: "nuk paralajmërohet".

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrje inspektuese kontrolluese bëhet pas skadimit të afatit të caktuar në aktin inspektues të miratuar nga ana e inspektorit, përkatësisht inspektorit të autorizuar me ç'rast inspektori gjatë konstatimit të gjendjes faktike do të konstatojë se subjekti i mbikëqyrjes:

- ka vepruar sipas masës inspektuese në tërësi,
- ka vepruar pjesërisht sipas masës inspektuese ose
- nuk ka vepruar sipas masës inspektuese.”

Paragrafi (5) shlyhen.

Neni 25

Në nenin 210 në alinenë 4 pas fjalës “tjetër” shtohen fjala “inspektues”.

Neni 26

Neni 211 ndryshohet si vijon:

“Para se të fillojë realizimi i mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese, inspektori, përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj i ndërmerr aktivitetet vijuese:

- sipas nevojës e thirr propozuesin e kërkesës, përkatësisht iniciativën ta plotësojë me dokumente të nevojshme ose t’i arsyetojë më hollësisht dhe

- bën vlerësim dhe kontroll profesional të kompetencës, detyrimeve dhe përgjegjësi të institucionit, çerdheve/qendrave për fëmijë për zhvillim të hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollës private, agjencisë për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe kujdes të fëmijëve të moshës parashkollore dhe personave fizikë që kryejnë punë të caktuara nga veprimtaria e mbrojtjes së fëmijëve.”

Neni 27

Në nenin 212 në paragrafin (1) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”, ndërsa pas fjalëve në kllapa “Institucion për fëmijë” vihet presje dhe shtohen fjalët: “çerdhe për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm për fëmijë të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucion të arsimit të lartë dhe shkollë private”.

Në paragrafin (2) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”.

Në paragrafin (3) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”, ndërsa fjalët: “ka të drejtë” zëvendësohen me fjalën “mund”.

Paragrafët (4) dhe (5) ndryshohen si vijon:

“(4) Inspektori, përkatësisht inspektori i autorizuar ka për obligim të veprorë në mënyrë të ligjshme dhe ta ruajë në kohë sekretin e të dhënave të klasifikuara.

(5) Personi udhëheqës ose personi tjetër në institucionin (qendër për punë sociale, institucioni për fëmijë, çerdhja për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijës si njësi organizative në bërje të personave juridikë, institucion të arsimit të lartë dhe shkollë private, agjenci për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe kujdes të fëmijëve dhe personave fizikë që kryejnë punë të caktuara të veprimtarisë), janë të detyruar që menjëherë pas skadimit të afatit të caktuar për zbatim të masës së shqiptuar inspektuese, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta njoftojnë me shkrim inspektorin përkatësisht inspektorin e autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj nëse janë ekzekutuar masa inspektuese.”

Neni 28

Neni 213 ndryshohet si vijon:

“Për mbikëqyrjen inspektuese, gjendja e konstatuar dhe parregullsitë e konstatuara inspektori, përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj përpilon procesverbal.”

Neni 29

Neni 214 ndryshohet si vijon:

“(1) Udhëheqësi i shërbimit inspektues për punën e shërbimit inspektues përgatit raport për gjashtë muajt paraprakë, më së voni deri më 15 korrik për periudhën janar - qershor në vitin rrjedhës të këtij viti, përkatësisht më së voni deri më 15 janar për periudhën korrik - dhjetor të vitit paraprak, i cili do të publikohet në ueb faqen e shërbimit inspektues.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, për punën e shërbimit inspektues, më së voni deri më 31 korrik përkatësisht 31 janar, dorëzohet në Këshillin Inspektues, në formë elektronike dhe në formë me letër.”

Neni 30

Pas nenit 214 shtohen dy nene të reja 214-a dhe 214-b, si vijojnë:

Neni 214-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara konstaton se është kryer parregullsi nga neni 226, 228, 229, 229-a, 230, 230-a, 230-b, 230-g, 230-d, 230-gj dhe 230-zh të këtij ligji, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar me aktvendim shqipton vërejtje dhe cakton afat në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar që t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë, të përcaktuara me procesverbalin.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në rast kur inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, do të vlerësojë se parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara mund të shkaktojnë ose shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve ose dëm financiar ose dëm të pronës me vlerë më të madhe ose rrezikim të mjedisit jetësor ose rrezikim të interesit publik, me aktvendim shqiptohet masë tjetër inspektuese, si detyrim, urdhër, ndalim ose masë tjetër, me të cilën në mënyrë më adekuate do të arrihet qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

(3) Nëse pas skadimit të afatit të caktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj konstaton se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, me aktvendim shqipton masë tjetër inspektuese, si detyrim, urdhër, ndalim dhe masë tjetër, me të cilën në mënyrë më adekuate do të arrihet qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Aktvendimi nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, miratohet menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit.

(5) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë konstatuar parregullsi dhe shkelje tjera të ligjit ose rregulla tjera ose parregullsitë e konstatuara janë mënjeluar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbal.

(6) Me përjashtim të paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të cekur në procesverbalin.

(7) Në rastin nga paragrafi (6) i këtij neni, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese.

Neni 214-b

(1) Për kundërvajtje për një ose më shumë punëtorë profesionalë të cilët i kryejnë drejtpërdrejt si dhe punëtorët tjerë të subjekti i mbikëqyrjes dhe subjektet e mbikëqyrjes do të shqiptohet vërejtje nëse kundërvajtja është kryer për herë të parë.

(2) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për vërejtjet e shqiptuara i përcakton ministri.”.

Neni 31

Në nenin 215, në paragrafët (1) dhe (3) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”.

Neni 32

Neni 216, në paragrafin (1) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”.

Në alinenë 1 pas fjalëve: “institucioni për fëmijë” vihet presje dhe shtohen fjalët: “çerdhe për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm për fëmijë të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucionit të arsimit të lartë dhe shkollës private”.

Në paragrafin (2) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”.

Neni 33

Në nenin 217, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Për ankesën kundër akteve inspekteuse vendos Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspekteuse dhe Procedurës për Kundërvajtje.”

Neni 34

Në nenin 218, në paragrafin (1) pas fjalës “institucioni” vihet presje, dhe shtohen fjalët: “çerdhe për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm për fëmijë të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucioni i arsimit të lartë dhe i shkollës private”, fjala “më i vështirë” zëvendësohet me fjalën “më i rëndë”, ndërsa fjalët: “person i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”.

Në paragrafin (2) pas fjalëve: “institucioni” vihet presje dhe shtohen fjalët: “çerdhe për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm për fëmijë të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucionit të arsimit të lartë dhe shkollës private”, ndërsa numri 214” zëvendësohet me fjalët: “215, paragrafi (1)”.

Në paragrafin (3) fjalët: “personi i autorizuar” zëvendësohen me fjalët: “inspektori i autorizuar”.

Neni 35

Në nenin 219 fjalët: “njoftimi nga neni 218, i këtij ligji” zëvendësohen me fjalët: “raporti për mbikëqyrjen e kryer inspekteuse”.

Në alinenë 1 pas fjalëve: “institucioni për fëmijë” vihet presje dhe shtohen fjalët: “çerdhe për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm për fëmijë të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucionit të arsimit të lartë dhe shkollës private”, ndërsa pas fjalëve: “neni 102 paragrafi (1)” shtohen fjalët: “edhe neni 102-a”.

Neni 36

Neni 224 shlyhen.

Neni 37

Neni 225 shlyhen.

Neni 38

Në nenin 226 në paragrafin (1) fjalët: “nga 500 euro deri në 1.000” zëvendësohen me fjalët nga “300 deri në 500” euro”.

Në paragrafin (2) fjalët: “nga 200 deri në 400” zëvendësohen me fjalët: “nga 150 deri në 200”.

Në paragrafin (3) fjalët: “nga 500 deri në 1.000” zëvendësohen me fjalët: “nga 150 deri në 200”.

Në paragrafin (4) fjalët: “nga 25 deri në 50” zëvendësohen me fjalët nga “70 deri në 150”.

Në paragrafin (5) fjalët: “nga 25 deri në 50” zëvendësohen me fjalët: “nga 70 deri në 150”, ndërsa fjalët: “paragrafi (8)” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (7)”.

Në paragrafin (6) fjalët: “nga 200 deri në 400” zëvendësohen me fjalët: “nga 300 deri në 500”.

Pas paragrafit (6) shtohet paragrafi i ri (7) si vijon:

“(7) Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro, në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik, nëse:

- menjëherë pas skadimit të afatit të caktuar për zbatimin e masës inspekteuse, e më së voni në afat prej tre ditësh nuk e ka njoftuar me shkrim inspektorin nëse janë ekzekutuar masa inspekteuse (neni 212, paragrafi (5)).”

Neni 39

Në nenin 228, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 800 deri në 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje institucionit për fëmijë, kopshtit për fëmijë/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucionit të arsimit të lartë dhe shkollës private, personit fizik i cili kryen punë të caktuara në mënyrë të mëvetësishme nga veprimtaria përkujdesje dhe edukim të fëmijëve nëse veprimtaria profesionale dhe agjencia për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe kujdes të fëmijëve nga mosha parashkollore, nëse:

- organizon organizim politik ose fetar dhe veprim edhe në institucionin për fëmijë, kopsht të fëmijëve/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollës private, përkatësisht të agjencia bëhet keqpërdorimi i fëmijëve nga shkaqet e njëjta, si dhe bëhet matlretimi psikik dhe fizik, ndëshkimi ose veprimi tjetër çnjerëzor ose keqpërdorimi i fëmijëve (neni 12),

- realizon programe që nuk janë miratuar nga organ kompetent (neni 168),

- realizon programe pa mendim të marrë pozitiv (nene 168, paragrafi (15) dhe 95 paragrafi (5)),

- realizon program i cili nuk është aprovuar nga ministri (neni 168, paragrafi (14)),

- nuk bashkëpunon me institucionet e veprimtarisë shëndetësore, përkatësisht nuk vepron sipas nenit 172, paragrafi (1) i këtij ligji,

- vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 172 paragrafi (2) i këtij ligji,

- nuk vepron ose nuk miraton program vjetor për punë (nenet 168 dhe 95),

- nuk i realizon standardet dhe normativat për kryerje të veprimtarisë (neni 100, paragrafi (3)),

- themelon institucion për fëmijë pa aprovim (neni 106),

- e prishë dedikimin dhe funksionin themelor të objektit në periudhën e zgjatjes së qirasë (neni 196),

- të fillojë punën dhe të kryejë veprimtari pa miratim dhe nuk i plotëson kushtet e përcaktuara, përkatësisht nëse kryen veprimtari pa vendim të organit kompetent (nenet 102 dhe 102-a)

- të fillojë punën pa marrë vendim për të kryer punë të caktuara nga veprimtaria (neni 78 paragrafi (3)),

- nuk njofton për pushimin e punës në institucionin privat (neni 113),

- Agjencia për dhënien e shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore nuk mban evidencë për shfrytëzuesit dhe shërbimet e ofruara (neni 79 paragrafi (1)),

- punëson persona në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj,

- nuk e mban evidencën e përcaktuar dhe dokumentacionin dhe e mban në kundërshtim me rregullat e përcaktuara (neni 195),

- përdor doracakë dhe revista për fëmijë për të cilat nuk ka vendim për miratim dhe përdorim (neni 173 paragrafi (3)),

- nuk u përmbahet çmimeve të përcaktuara nga organi kompetent për shërbimet (neni 191),

- nuk paraqet ose lejon prindërit të zgjedhin doracakë dhe revista për fëmijë të cilat janë në funksion për realizimin e aktiviteteve në institucionin për fëmijë (neni 173, paragrafët (4) dhe (5)),

- paraqet të dhëna false si dhe përdor në mënyrë të paligjshme ose të parregullt mjetet (neni 192),

- nuk mundëson kryerjen e mbikëqyrjes (neni 212),

- nuk realizon programe nga neni 168 paragrafët (11) dhe (12),

- nuk i kryen masat e shqiptuara dhe veprimtaritë (neni 215) dhe

- nuk respekton ndalesën për punë të institucionit për fëmijë, kopshtit për fëmijë / qendrës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridik, institucionin e arsimit të lartë dhe shkollën private, një agjencinë për dhënien e shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore (neni 219)."

Në paragrafin (2) fjalët: "nga 30% e gjobës së përcaktuar për personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "nga 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë".

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

"Gjobë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni i shqiptohet personit udhëheqës si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucionit

të arsimit të lartë dhe shkollës private, agjencisë për dhënien e shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore dhe udhëheqësit të objektit të institucionit publik për fëmijë."

Në paragrafin (4) fjalët: "nga 100 deri 150", zëvendësohen me fjalët: "nga 150 deri 200",

Në paragrafin (5) fjalët: "nga 1.000", zëvendësohen me fjalët: "nga 300 deri 500".

Në paragrafin (6) fjalët: "nga 1.000", zëvendësohen me fjalët: "nga 300 deri 500".

Në paragrafin (7) fjalët: "nga 100 deri 150", zëvendësohen me fjalët: "nga 150 deri 200",

Neni 40

Neni 229 Në paragrafin (1) fjalët: "nga 1.000", zëvendësohen me fjalët: "nga 800 deri 1.000".

Në paragrafin (2) fjalët: "nga 30% e gjobës së përcaktuar për personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "nga 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarin".

Neni 41

Paragrafi 229-a ndryshon si vijon:

"(1) Gjoba në shumë prej 150 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarin i shqiptohet për kundërvajtje personit që punon në institucion për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve nga mosha parashkollore kopshti për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijës të themeluar si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucion i arsimit të lartë dhe shkollë private, person i punësuar nga agjencia për dhënien e shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore dhe të personit fizik i cili në mënyrë të pavarur kryen detyra të caktuara në profesionin e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve si veprimtari profesionale nëse nuk e posedon licencën përkatëse për punë (neni 178 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në institucionin për fëmijë, kopshtin për fëmijë / qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijës të themeluara si njësi organizative në përbërje të personave juridikë, institucionit të arsimit të lartë dhe shkollës private, personit fizik i cili në mënyrë të pavarur kryen detyra të caktuara në veprimtarinë përkujdeje dhe edukim të fëmijëve si veprimtari profesionale dhe agjencia për dhënien e shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore, nëse punëson ose angazhon person që nuk posedon licencë adekuate të vlefshme për punë (neni 178, paragrafi (1)).

(3) Gjobë në shumë prej 800 deri në 1,000 euro në kundërvlerë në denarë do ti shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse punon ose angazhon person i cili nuk ka licencë të vlefshme adekuate për punë (neni 178 paragrafi (1))."

Neni 42

Në nenin 230 në paragrafin (1) fjalët: "nga 400", zëvendësohen me fjalët: "nga 200 deri 400".

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do ti shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në person juridik".

Neni 43

Në paragrafin 230-b fjalët: “nga 100 deri 150”, zëvendësohen me fjalët: “nga 150 deri 200”.

Neni 44

Paragrafi 230-v shlyhet.

Neni 45

Në nenin 230-g fjalët: “nga 2.000 deri 3.000”, zëvendësohen me fjalët: “nga 200 deri 400”.

Neni 46

Në nenin 230-d fjalët: “nga 10.000”, zëvendësohen me fjalët: “nga 800 deri 1.000”.

Neni 47

Në nenin 230-gj fjalët: “nga 2.000 deri 3.000”, zëvendësohen me fjalët: “nga 300 deri 500”.

Neni 48

Neni 230-e shlyhet.

Neni 49

Në nenin 230-zh fjalët: “nga 2.000 deri 3.000”, zëvendësohen me fjalët: “nga 300 deri 500”.

Neni 50

Neni 231 ndryshon si vijon:

“(1) Për kundërvajtjet nga neni 226, 227, 228, 229, 229-a, 230, 230-a 230-b, 230-g, 230-d, 230-gj dhe 230-zh të këtij ligji, inspektori kompetent para paraqitjes së kërkesës fillimin e procedurës kundërvajtëse është i obliguar kryerësit t'i propozojë procedurë për barazim duke lëshuar urdhërpagesë kundërvajtëse në përputhje me Ligjin për kundërvajtjet.

(2) Nëse kryesi nuk pranon t'i lëshohet urdhërpagesë kundërvajtëse, e njëjta do të shënohet në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar dhe personi i autorizuar zyrtar do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

(3) Kur kryesi i kundërvajtjes pajtohet me procedurën e barazimit, inspektori përpilon procesverbal dhe lëshon urdhërpagesë kundërvajtëse personit përgjegjës ose një personi të autorizuar nga ai te punëdhënësi.

(4) Procesverbalin dhe urdhërpagesa nënshkruhen nga inspektori dhe kryerësi i kundërvajtjes. Pas marrjes së urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësi është i detyruar të paguajë gjobën e shqiptuar në urdhërpagesën kundërvajtëse brenda tetë ditëve nga dita e marrjes së urdhërpagesës kundërvajtëse, në llogri të organit të emëruar në urdhërpagesën kundërvajtëse.

(5) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës ose personi i autorizuar nga ai.

(6) Kryerësi që paguan gjobën në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, do të paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar për të cilën të drejtë këshillohet në udhëzimin ligjor.

(7) Nëse kryesi nuk e paguan gjobën brenda afatit nga paragrafi (4) i këtij neni, inspektori paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në organin kompetent.

(8) Në procedurën e barazimit dënimi në urdhërpagesën kundërvajtëse shqiptohet në shumë minimale të parapara për kundërvajtjen.

(9) Në procedurën që do të përfundojë me pagesën e urdhërpagesës kundërvajtëse nuk paguhen shpenzimet e procedurës.

(10) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse i përcakton ministri.”

Neni 51

Procedurat e filluara për kërkesat për realizimin e të drejtave të shtesave për fëmijë për arsimimit deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në përputhje me këtë ligj.

Përdoruesit e së drejtës për shtesa për fëmijë dhe shtesës për arsimim do të vazhdojnë ta shfrytëzojnë të drejtën në pajtim me këtë ligj.

Neni 52

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Akti i kompetencave profesionale të kuadrit profesional dhe udhëheqës nga neni 17 i këtij ligji do të miratohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 53

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 54

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

4301.

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

У К А З**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА СПРЕЧУВАЊЕ ПЕРЕЊЕ ПАРИ И ФИНАНСИРАЊЕ НА ТЕРОРИЗАМ**

Се прогласува Законот за дополнување на Законот за спречување перење пари и финансирање на тероризам,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 27 декември 2019 година.

Бр. 08-7148/1
27 декември 2019 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
Стево Пендаровски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi, с.р.**